

# BULETINI

NR.15, VITI XI



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENOŠA I TRŽIŠTA A.D.



KOSTT sh.a pjesë e iniciativës për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, së bashku me tetë vende të Evropës Juglindore .....	3
KOSTT merr pjesë në Samitin për Sigurinë Kibernetike të Shërbimeve të energjisë .....	3
Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë z.Qemal Minxhozi .....	4
Ilir M. Shala emërohet Kryeshefi i ri i KOSTT sh.a .....	4
Devijimet e frekuencës në Sistemin Elektroenergjetik të Evropës Kontinentale .....	5
Menaxhmenti dhe Bordi i KOSTT pritën në takim Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik si dhe përfaqësues të KDI .....	6
KOSTT vazhdon përkrahjen përfmijët e Kosovës .....	7
Mbahen Dëgjime Publike për projektet e KOSTT sh.a përfmijët e Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës .....	7
KOSTT mbështet zhvillimin e mëtejshëm të iniciativës përfmijët e Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës .....	8
Nënshkruhet Marrëveshja përfmijët e Kyçje në Sistemin Transmetues me Kapacitetin më të madh Gjenerues nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë .....	9
Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim Zyrtarin e Lartë të Ministrisë përfmijët e Bashkëpunimit dhe Zhvillim Ekonomik të Republikës Federale Gjermane z. McCormack .....	10
KOSTT nënshkroi Letër Bashkëpunimi me USAID dhe Tetra Tech përfmijët e programit përfmijët e barazinë gjinore dhe fuqizimin e pozitës së grave në ndërmarrje .....	10
Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a merr pjesë në Samitin e Dytë të Investimeve Ndërkombëtare dhe Ekspozitën "Hidrocentralet e Ballkanit 2018" .....	11
Iniciativa e Tregut të Energjisë Elektrike (EMI).....	12
U mbajt Tryezë Pune më temë "APEX Tregu i Përbashkët Energjetik një ditë para dhe brenda ditës ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë" .....	12
Roli i KOSTT në kuadër të projektit Autostrada Digitale Ballkanike/"Balkans Digital Highway" .....	13
KOSTT shpërblehet me çmimin Mbështetësi më i gjatë i njëpasnjëshëm nga Fondi Kosovaro-Amerikan përfmijët e Edukim .....	14
Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT pjesë e Konferencës mbi Tranzicionin e Energjisë "Sfidat dhe Mundësitë në Kosovë përfmijët e rajon" .....	15

**Buletini nr.15, Viti XI**  
**Buletini është publikim i KOSTT sh.a,**  
**Rr. Isa Boletini, Nr. 39, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës**  
**Tel: +383(0) 38 501 301 174; email: info@kostt.com**  
**Web: www.kostt.com**

**Për më shumë informata rrëth Buletinit, ju lutem kontaktoni:**  
**Zyrën përfmijët e Komunikim dhe Relacione me Publikun në:**  
**[zana.rama@kostt.com](mailto:zana.rama@kostt.com) ose [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)**

## KOSTT sh.a pjesë e iniciativës pér zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, së bashku me tetë vende të Evropës Juglindore

Nën iniciativën e Asociacionit të Energjisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) dhe të Agjensionit Amerikan pér Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), më 16 korrik 2018 në Podgoricë të Malit të Zi, u nënshkrua Memorandum i Mirëkuptimit pér Iniciativën e Tregut të Energjisë Elektrike (Electricity Market Initiative-EMI) në mes të operatorëve të sistemit të transmisionit (OST) dhe operatorëve të tregut, nga tetë vende të Evropës Juglindore, përkatësisht: Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia.

Sipas Memorandumit, vendet nënshkruese janë pajtuar që të ndajnë të dhënat pér gjenerimin, transmetimin dhe tregun e energjisë elektrike, me qëllim të optimizimit të rrjetit rajonal si dhe tërheqjes së investimeve ndërkombëtare.

Iniciativa synon të përmirësojë efikasitetin e tregut, të nxis konkurrencën dhe të inkurajojë gjenerimin alternativ të energjisë elektrike.

Me rastin e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit pér Iniciativën e Tregut të Energjisë Elektrike, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala, u shpreh "jam shumë optimist që nënshkrimi i këtij memorandumi do të jetë faktor nxitis në rritjen e bashkëpunimit dhe transparencës në mes të vendeve nënshkruese, si një element thelbësor në drejtim të zhvillimit të tregut rajonal të energjisë, kjo duke marrë parasysh kërkosha gjithnjë në rritje pér energji elektrike".



## KOSTT merr pjesë në Samitin pér Sigurinë Kibernetike të Shërbimeve të energjisë

Nën patronatin e Agjensionit Amerikan pér Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Asociacionit të Energjisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID), gjatë muajit Dhjetor në Londër u mbajt "Samiti pér Sigurinë Kibernetike të Shërbimeve të energjisë" ku pjesëmarrës në samit ishte Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala me bashkëpunëtor.

Iniciativa pér sigurinë kibernetike është një element programor i Iniciativës së USAID-it pér Sektorin e Energjisë. Utilities Cyber Security Initiative UCSI u krijuar nga operatorët e sistemit të transmetimit dhe të gazit natyror si dhe kompanitë e shpërndarjes në rajonin e Evropës dhe Euroazisë si përgjigje ndaj sulmeve kibernetike gjithnjë e më virulente në rrjetin elektrik në këto vende. Objektivë e kësaj iniciative ka qenë sigurimi i një forumi të vazhdueshëm pér ndërmarrjet e Evropës dhe Euroazisë në shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira, shtrirja dhe fushëveprimi i sulmeve kibernetike në rrjetin elektrik global, vendosja e teknologjive të informacionit dhe operacioneve pér të forcuar sigurinë kibernetike, menaxhimi i burimeve njerëzore pér të përmirësuar praktikat e mirëmbajtjes në internet dhe promovimi i përdorimit të standardeve ndërkombëtare të sigurisë kibernetike në rajonin e Evropës dhe Euroazisë. Gjithashtu kjo iniciativë do të ofrojë një forum pér shkëmbimin e informacionit midis ekzekutivit të ndërmarrjeve të nivelit të lartë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Evropës dhe Euroazisë në lidhje me shkallën e sulmit kibernetik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Evropë dhe Euroazi, ndryshimet organizative në përgjigje të mjedisit kërcënues në zhvillim si dhe bashkëpunim të vazhdueshëm të sigurisë kibernetike ndërmjet ndërmarrjeve.



Ngjarja mbodhi operatorët e sistemit të transmisionit (OST) nga Evropa, rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë, pjesë e së cilës ishte edhe delegacioni i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a) i kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z.Ilir M.Shala.



## Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë z.Qemal Minxhozi

U.D Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu me bashkëpunëtorë, në muajin shkurt të vitit 2018 priten në takim Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë z.Qemal Minxhozi.

Në takim u diskutua rreth bashkëpunimit të fryshtës në sektorin e energjisë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, progresit në krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike si dhe procesit të themelimit të bursës shqiptare të energjisë (APEX) ku Kosova përmes KOSTT do të jetë aksionare.

Në kuadër të takimit, në veçanti u diskutua rreth sfidave në drejtim të fillimit të implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT-ENTSO-E me të cilën është e ndërlidhur edhe vënia në operim e linjës së re interkonektive 400 KV Kosovë-Shqipëri projekt kapital i cili u bashkëfinancua me Qeverinë Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW).



Ambasadori Minxhozi si dhe u.d.Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadriu shprehën shqetësimin e tyre për bllokimin e vënieve në funksion të linjës 400 KV Kosovë-Shqipëri tashmë 1 vit e gjysmë nga inaugurimi i projekteve, si dhe u pajtuan që është e nevojshme zgjidhja e këtij ngërçi i cili do të mundëson valorizimin e këtij projekti kapital me interes si për sigurinë e furnizimit me energji elektrike ashtu dhe për sigurinë dhe besueshmërinë e sistemeve elektroenergetike të Kosovës, Shqipërisë dhe rajonit në përgjithësi.

## Ilir M. Shala emërohet Kryeshef i ri i KOSTT sh.a

Në takimin e mbajtur me 1 mars 2018, Bordi i Drejtoreve të KOSTT sh.a pas një procedure të hapur dhe konkuruese ka marrë vendim që të emërojë z. Ilir M. Shala, Kryeshef Ekzekutiv të KOSTT sh.a.

z.Ilir M. Shala - Magjistër i shkencave elektroinxezierike nga Universiteti i Prishtinës si dhe Magjistër i shkencave në menaxhim të shërbimeve dhe liderësit nga Rochester Institute of Technology (RIT Kosovë), mban një eksperiencë mbi 18 vjeçare në sektorin e energjisë.

Në periudhën 2003-2006, ai ka mbajtur pozitën e drejtorit të Departamentit për Projekte dhe Investime në Divizionin e Transmisionit dhe Dispeçingut në KEK, pozitë me të cilën ka vazhduar edhe në KOSTT, që nga themelimi në vitin 2006.

Nga muaji qershor 2017 deri më 1 mars 2018, z.Shala ka mbajtur pozitën e zv.Kryeshefit Ekzekutiv për Zhvillim në KOSTT sh.a.

Z.Shala ka ndjekur programe të ndryshme të liderësit përfshirë dhe programin "International Visitor Leadership Program (IVLP)", me ftesë të Departamentit Amerikan të Shtetit si dhe është anëtar aktiv i KUSA (Kosovo United States Alumni).

z.Ilir M. Shala i lindur në maj të vitit 1970, është i martuar dhe ka tre fëmijë.



## Devijimet e frekuencës në Sistemin Elektroenergetik të Evropës Kontinentale

Përkundër që KOSTT ka plotësuar të gjitha parakushtet teknike dhe operative në pajtim me kërkesat e ENTSO-E për të funksionuar si bllok/zonë rregulluese në bazë të Marrëveshjes për Kyçje (Connection Agreement) e cila u nënshkrua me 1 tetor 2015 në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, kjo Marrëveshje ende nuk ka hy në fuqi për shkak të obstruksioneve të vazhdueshme të Serbisë në implementimin e obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja për Energji ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Dialogu i Brukselit).

Situata e krijuar me devijimin e frekuencës së Sistemin Elektroenergetik të Evropës Kontinentale, në fillim të vitit 2018, është edhe si pasojë e mos-implementimit të Marrëveshjes për Kyçje KOSTT-ENTSO-E nga ana e EMS (Operatori i Sistemit të Transmisionit të Serbisë) si pasojë e mos implementimit të së cilës KOSTT ka dëme financiare. Marrëveshjen për Kyçje KOSTT/ENTSO-E e ka nënshkruar edhe vet EMS së bashku me 29 OST të tjera evropiane.

Sipas vendimit të ZRrE, nga muaji prill 2017 me qëllim të krijimit të kushteve për hapjen e tregut të energjisë me pakicë, përgjegjësinë për të mbuluar humbjet nga furnizimi me energji elektrike për pjesën veriore të Kosovës, nga Kompania Furnizuese KESCO i'a ka kaluar KOSTT-it (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike në Kosovë), mjete të cilat KOSTT i ka siguruar përmes tarifave të energjisë elektrike, sipas rregullave në fuqi.

Pas Vendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës për të hequr koston e furnizimit të veriut nga faturat e energjisë elektrike, çështje e cila është ngritur nga Avokati i Popullit në Kosovë, dhe udhëzimit të Zyrës së Rregulatorit të Energjisë (ZRrE) në lidhje me këtë çështje që më pas ka pasuar me zvogëlimin e tarifave të KOSTT për 44%, KOSTT nuk ka pasur mundësi ligjore si dhe financiare për të marrë obligim mbulimin e mëtutjeshëm të humbjeve nga furnizimi me energji elektrike për pjesën veriore të Kosovës për periudhën në vijim (dhjetor 2017-mars 2018), për shkak të kostos financiare që bartë kjo.

Mungesa e të hyrave financiare e dëmon ton qëndrueshmérinë financiare të kompanisë si kompani e rregulluar, karshi obligimeve për operim të sigurtë dhe të besueshëm të Sistemit Transmetues të Kosovës, përbushjet së obligimeve ndaj kreditorëve të jashtëm (KfW, BERZH/EBRD) si dhe rrezikon procesin drejt anëtarësimit të KOSTT në ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike).


Aktualisht, deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për Kyçje në mes të KOSTT/ENTSO-E, KOSTT operon si pjesë përbërëse e EMS (Serbi) në Zonën Kontrolluese dhe Bllokun Kontrollues SMM (ku bëjnë pjesë Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi) ku si lidere e bllokut EMS ka përgjegjësinë për balancimin e sistemit ndaj OST-ve të Evropës Kontinentale. Mos implementimi i Marrëveshjes për Kyçje KOSTT/ENTSO-E gjithashtu po i shkakton dëme financiare KOSTT-it, pasi që operatori serb EMS vazhdon që të ketë përfitime milionëshe nga alokimi i kapaciteteve të linjave kufitare të Kosovës me shtetet fqinje ku konkretisht për vitin 2017 në mënyrë të kundërligjshme EMS ka inkasuar 9.6 Milion EUR. Me përkrahjen financiare të Qeverisë së Kosovës, KOSTT nga data 3 mars 2018, ora 00.00h ka ndërprerë devijimet ndaj rrjetit interkonektiv.

### Informacione shtesë sqaruese:

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Energji në mes të Kryeministrat të Kosovës dhe atij të Serbisë nën ndërmjetësimin e Komisionit Evropian në shtator 2013, e cila rezultoi edhe me nënshkrimin e Marrëveshjes për Operim (inter-TSO Agreement) në mes të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Serbisë (EMS) në shtator të vitit 2014, dhe konfirmimit të Marrëveshjes për Energji me datë 25 gusht 2015 në mes të Kryeministrave respektiv, është përcaktuar që KOSTT dhe EMS do te fillojnë operimin si dy zona rregulluese të pavarura në përputhje me kërkesat e ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike).

Pas një procesi të gjatë të verifikimit të aspekteve teknike dhe operative nga ana e ENTSO-E, me 1 tetor 2015 në Bruksel është nënshkruar Marrëveshja për Kyçje të Sistemit Energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale.

Marrëveshja për Kyçje është nënshkruar në mes të KOSTT si Operator i Sistemit të Transmisionit (OST) të Kosovës në njëren anë dhe ENTSO-E në anën tjetër e përfaqësuar nga 30 OST të Grupit Regional të Evropës Kontinentale. Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Kyçje, KOSTT bëhet zonë/blllok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Europës Kontinentale.



Sipas Marrëveshjes për Kyçje, regjistrimi dhe licencimi i kompanisë furnizuese në veri është parakusht për fillimin e operimit të KOSTT-it si zonë/blllok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Europës Kontinentale, ndërsa kjo kompani ende nuk është regjistruar në Kosovë.

Operatori i Sistemit të Transmisionit të Serbisë (EMS) me veprimet e saj jo të drejta vazhdon ti shkaktoj dëme financiare KOSTT-it dhe konsumatorëve të Kosovës në përgjithësi duke shkelur dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, për të cilën KOSTT ka dorëzuar edhe ankesë formale në gusht të vitit 2008 në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore (SKE nr.ECS-3/08).

## **Menaxhmenti dhe Bordi i KOSTT pritën në takim Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik si dhe përfaqësues të KDI**

Menaxhmenti i KOSTT sh.a në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.llir M. Shala si dhe anëtarët e Bordit të KOSTT, në muajin mars 2018 pritën në takim kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të Kuvendit të Republikës së Kosovës znj. Sala Berisha-Shala dhe anëtaren e Komisionit znj. Mimoza Kusari-Lila, si dhe përfaqësues të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI).

Qëllimi i këtij takimi i cili u organizua nga KDI ishte informimi i drejt-përdrejt i Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Energji të arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në kuadër të Dialogut të Brukselit dhe çështjen e furnizimit dhe faturimit të energjisë elektrike për pjesën veriore të Kosovës.

Me këtë rast, përfaqësuesit e KOSTT njofuan Komisionin Parlamentar në lidhje me obstrukzionet e vazhdueshme të Serbisë si dhe me dëmet e vazhdueshme financiare që po i shkaktohen KOSTT-it dhe Kosovës në përgjithësi si pasojë e mos hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Kyçje në mes të KOSTT/ENTSO-E për shkak të mos-implementimit nga ana e Serbisë të obligimeve nga Marrëveshja për Energji ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, KOSTT kërkoi nga Komisioni Parlamentar që të ngrisin këtë çështje në Kuvend dhe të kërkojnë nga Qeveria që të gjejnë sa më shpejtë një zgjidhje të qëndrueshme. Deputetet u zotuan se do të adresojnë sa më shpejtë këto çështje dhe do të kërkohet që çështja në fjalë të trajtohet me prioritet nga institucionet relevante.



## KOSTT vazhdon përkrahjen për fëmijët e Kosovës

Në vazhdën e përgjegjësisë sociale, KOSTT sh.a konfirmoi edhe një herë përkushtimin përfshirë të kontribuar në mirëqenien e shoqërisë sonë duke dhënë përkrahje financiare përfshirë fëmijët e diagnostikuar me kancer si dhe fëmijët e porsalindur që përballen me probleme shëndetësore.

Në kuadër të kësaj, KOSTT është bërë pjesë e iniciativës së komunitetit të Bankës Evropiane përfshirë Rindërtim dhe Zhvillim BERZH (EBRD Community Initiative) përfshirë mbledhur fonde përfshirë sigurimin e medikamenteve përfshirë fëmijët e diagnostikuar me kancer që trajtohen në Klinikën Pediatrike Onkologjike në QKUK, përmes fondacionit "Care for Kosovo Kids" (CfKK/FKfK). Ky Fondacion që nga viti 2013 është i angazhuar në shpëtimin e jetës së fëmijëve, duke siguruar përmes donacioneve trajtimin e nevojshëm përfshirë 60 fëmijë, çdo vit.



KOSTT gjithashtu ka dhënë donacion në përkrahje të fëmijëve të porsalindur me probleme shëndetësore që trajtohen në Klinikën e Neonatologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, përmes fondacionit "Action for Mothers and Children" (AMC).

Fondacioni AMC zhvillon programme të ndryshme në përkrahje të përmirësimit të kujdesit të grave shtatzëna dhe foshnjave të lindura para kohës përfshirë sigurimin e medikamentit "Surfaktant" i nevojshëm përfshirë foshnjat që përfjetojnë probleme të fryshtëzimeve si mungesë e surfaktantit – shtresë e lëngshme brenda mushkërive si dhe zgjerimin e shërbimeve të Qendrave Shëndetësore përfshirë Gratë.

Me përkushtimin përfshirë të kontribuar në mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve kosovar, në prag të ndrrimit të moteve buxhetit të dedikuar përfshirë dhurata përfshirë partnerët e biznesit KOSTT i dha orientim human.

## Mbahen Dëgjime Publike përfshirë projektet e KOSTT sh.a përfshirë zhvillimin e Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës

Nën organizimin e Operatorit të Sistemit Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a) dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, u mbajtën Dëgjime Publike në Komunën e: Drenasit, Rahovecit, Therandes, Graçanicës si dhe në Komunën e Fushë Kosovës përfshirë shpronësim përfshirë interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projekteve në kuadër të projektit përfshirë zhvillimin e Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës : LOT 3- Largpërcuesit dhe kabllot transmetuese.

Gjatë këtyre seancave dëgjimore në të cilat morën pjesë qytetarët e komunave respektive dhe përfaqësuesit e institucioneve qendrore si dhe qytetarët/institucionet e prekur nga këto shpronësimi/servitute, fillimisht u informuan përfshirë afërmimi me projektin dhe mbi rëndësinë që ka realizimi i këtyre projekteve përfshirë sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike përfshirë komunat e tyre i cili u prezantua nga përfaqësuesit të KOSTT sh.a, si dhe me të gjitha procedurat që duhet të i ndërmarrin pas këtyre dëgjimeve publike.



Projekti përfshirë zhvillimin e Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës është projekt i KOSTT sh.a dhe bashkë-financohet me Bankën Evropiane përfshirë Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

## KOSTT mbështet zhvillimin e mëtejshëm të iniciativës për ndarjen e përbashkët të "Infrastrukturës Digitale Ballkanike"/"Balkans Digital Highway"

KOSTT sh.a mbështet zhvillimin e mëtejshëm të iniciativës për ndarjen e përbashkët të infrastrukturës rajonale "Balkans Digital Highway" (Autostrada Digitale Ballkanike), të propozuar nga Banka Botërore. Kjo përkrahje vjen si përgjigje ndaj konkluzioneve të miratuara në punëtorinë kushtuar iniciativës e cila u mbajt në Tiranë, Shqipëri, më 26 dhe 27 shtator 2018. Ngjarja mblodhi operatorët e sistemit të transmisionit (OST) nga rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë, pjesë e së cilës ishte edhe delegacioni i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a) i kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z.Illir M. Shala.



Punëtoria dhe vetë iniciativa dolën nga nisma e Bankës Botërore për Autostradën Digitale Ballkanike. Pjesëmarrësit e punëtorisë në Tiranë diskutuan gjetjet nga studimet e para-fizibilitetit të gjeneruara nga iniciativa, si dhe diskutuan mbi pikat strategjike për të ardhmen e iniciativës. Ky shkëmbim u pasurua përmes paraqitjes së rasteve studimore të nivelit shtetëror dhe rajonal nga vendet Baltike, Amerika Qendrore, Greqia, Letonia, Rumania dhe Sllovenia mbi ndarjen/shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës së energjisë elektrike dhe telekomunikacionit.

Me këtë rast, udhëheqësja e ekipit të punës së Asistencës Teknike të Bankës Botërore znj. Natalija Gelvanovska-Garcia ka bërë një përbledhje mbi rëndësinë e ecjes përpara me iniciativën: "Nëpërmjet Autostradës Digitale Ballkanike ne po punojmë për të inkurajuar shkëmbimin efikas të infrastrukturës në dispozicion të fibrave optike, duke përfshirë edhe hapësirën përtëj kufijve. Kjo do t'i parandalonte qeveritë dhe sektorin privat nga investimi i tepruar në rrjetet e qasjes "broadband". Sipas hulumtimit tonë, operatorët e sistemit të transmisionit në Ballkanin Perëndimor kanë asete të konsiderueshme shtesë të fibrave optike të cilat kryesisht përdoren në nivel të ultë. Duke pasur parasysh kërkësën e lartë për infrastrukturë shtesë të rrjetit kryesor (backbone) nga sektori i telekomunikacionit, kompanitë energjetike mund të angazhohen në ndarjen e infrastrukturës përmes dhënies me qira të qasjes sipas kushteve komerciale për ofruesit e interesuar të shërbimeve të internetit. Një veprim i tillë do të krijonte një situatë të quartë financiare "të favorshme" për të dy kompanitë e shërbimeve dhe kompanitë e internetit".

Në anën tjetër, Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT z.Illir M. Shala ka theksuar: "KOSTT është një nga OST-të e para nga Ballkani Perëndimor që tashmë ka filluar me ofrimin e shërbimeve për shfrytëzimin me qera të rrjetës së lirë/të pashfrytëzuar të fibrave optik (dark fiber/të pa-ndriçuar). Deri më tanë ne kemi nënshkruar katër marrëveshje të suksesshme me operatorët e interesuar të shërbimeve telekomunikuese dhe me këtë rast i inkurajoj edhe OST-të e tjera të rajonit që të ndjekin këtë model".

Pjesëmarrësit e punëtorisë mbështetën qasjen e propozuar nga Banka Botërore, që ishte vazhdimi i programeve të asistencës teknike në nivel kombëtar dhe rajonal për të mbështetur ato ndërmarrje që ende nuk janë të angazhuara në ndarjen e infrastrukturës për shkak të kufizimeve të kapaciteteve, rregullatore ose të tjera.

Faza e fundit e iniciativës do të përfshinte fillimin e ndarjes së infrastrukturës rajonale mes vendeve fqinje. Perspektiva e kësaj ndodhje është tashmë e lartë, pasi që OST-të pjesëmarrëse kanë rënë dakord të krijojnë një grup joformal për ndarjen e përbashkët të infrastrukturës, që, ndër të tjera, do të bashkërendojnë standarde për interkoneksione dhe të ndajnë informacione rreth rrjetave të fibrave.

Asistenca Teknike për Autostradën Digitale në Ballkan, administruar nga Departamenti për Zhvillim Digital i Bankës Botërore, është financuar nëpërmjet Njësisë Këshillimore për Infrastrukturën Publiko Private (PPIAF), një njësi për asistencë teknike nga donatorë të shumtë, e përbërë nga donatorë multilateral dhe bilateral. Iniciativa ka mbuluar të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimorë, duke u angazhuar me një shumëlojshmëri të akterëve në sektorin e energjisë dhe TIK-ut përgjatë periudhës 2017-2018. KOSTT sh.a merr pjesë në Asistencën Teknike të Bankës Botërore që nga viti 2017.

Samiti i Triestes i mbajtur në korrik të vitit 2017 ka ofruar mbështetje politike për iniciativën duke përfshirë në Planin Shumëvjeçar të Veprimit një veprim që ka të bëjë me fillimin e dialogut rajonal për komercializimin e aseteve rezervë/të pa përdorura të fibrave optike dhe për adresimin e kufizimeve që pengojnë procesin.

Që nga viti 2004, paralel me zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike, KOSTT po ashtu ka ndërtuar dhe zhvilluar rrjetin e ri telekomunikues të bazuar në fibra optik OPGW (Optical Power Ground Wire), me gjatësi mbi 1100 km të vendosur nëpër largpërçues të tensionit të lartë, brenda gypave në bërthamën e të cilëve në shumicën e rasteve janë vendosur 48 fije optike, përvèç rasteve të pakta me 24 dhe 96 fije optike. Ky rrjet është mjaft i avancuar dhe i aftë të ofroj shërbime komunikuese dhe të informacionit në qytetet dhe vendbanimet kryesore në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

## **Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje në Sistemin Transmetues të kapacitetit më të madh gjenerues nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë**

Më 18 maj 2018 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a z.Ilir M. Shala dhe Drejtori i SOWI Kosovë z.Ilir Grapci nënshkruan Marrëveshjen për Kyçje në Sistemin Transmetues të Kosovës të Parkut energetik me Erë, Selaci 1, 2 dhe 3.

Kapaciteti i përgjithshëm i instaluar i Parkut Energetik SELACI prej 105 MW i cili njëherit përbën gjeneruesin më të madh të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme (BRE) do të kyçet në rrjetin e tensionit të lartë 110 kV që është mjaftë mirë i zhvilluar si dhe i shpërndarë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Investimet e vazhdueshme të cilat i ka realizuar KOSTT në Sistemin Transmetues gjatë dekadës së fundit, kanë krijuar kushte të favorshme për akomodimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike dhe njëherit përkrahjen e integrimit të burimeve të ripërtëritshme në rrjetin transmetues.

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Ilir M. Shala theksoi

“Krijimi i këtyre kushteve është me rëndësi sidomos duke pasur parasysh që shfrytëzimi i BRE-ve përbën objektiv afatgjatë të politikave energjetike të vendit në mbështetje të zhvillimit ekonomik, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit si dhe arritjes së caqeve të politikave shtetërore për pjesëmarrje prej 25% të energjisë nga BRE-të në bruto konsumin final të energjisë deri në vitin 2020, kjo në pajtim me politikat e Bashkimit Evropian”.

Pas shqyrtimit të aplikacionit nga KOSTT dhe nënshkrimit të Marrëveshjes për Kyçje në Sistemin Transmetues, Parku Energetik Selaci 1, 2 dhe 3, investim Kosovaro-Gjerman, do të ndërtohet në pjesën veriore të Bajgorës dhe pritet që të fillojë me gjenerimin e megavateve të parë në vitin 2020.



## Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim zyrtarin e lartë të Ministrisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik të Republikës Federale Gjermane z. McCormack

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z.Ilir M. Shala me bashkëpunëtorë, me 26 Nëntor 2018 priti në takim një delegacion të zyrtarëve të lartë të Republikës Federale Gjermane të udhëhequr nga z. Daniel McCormack, Zyrtar i Lartë i Divizionit për Evropën Juglindore (EJL) dhe Kaukazin e Jugut në Ministrinë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik të Republikës Federale Gjermane dhe znj. Anja Becky, sekretare e parë në Ambasadën e RF të Gjermanisë në Kosovë.



z. Shala falenderoi delegacionin gjerman për mbështetjen e vazdueshme si dhe i njoftoi me të arriturat e kompanisë ku u potencua bashkëpunimi i frytshëm në mes të Qeverisë Gjermane përmes KfW dhe KOSTT, në aspektin e përkrahjes zhvillimore të ofruar që nga themelimi i KOSTT e deri më tani. "Projektet madhore si Paket Projekti Peja 3, Linja 400 kV Kosovë -Shqipëri dhe Load-FrequencyControl si dhe shume projekte të tjera zhvillimore janë fakte të bashkëpunimit të shkëlqyer në mes të KOSTT dhe KfW dhe ato përbëjnë rreth 32 % të vlerës së aseteve të KOSTT" u shpreh z. Shala.

Implementimi i projekteve të finacuara nga KfW mundësoi ngritjen e performancës operuese të sistemit transmetues, ngritjen e kualitetit të furnizimit dhe reduksionin e humbjeve teknike. Bashkëpunimi me Qeverinë Gjermane përmes KfW do të vazhdoj edhe përfundimtarit e zhvillimit të investimeve (faza VI dhe VII) e cila është e fokusuar në projektet e përkrahjës së ngarkesës në regjione të ndryshme të Republikës së Kosovës, si dhe në ngritjen e kapaciteteve transformuese dhe transmetuese të rrjetit.

Në takim gjithashtu u diskutua për sfidat me të cilat po ballafaqohet KOSTT, me theks të veçantë u potencua mos implementimi i Marreveshjes së Kyçjes me ENTSO-E, e bllokuar nga pala serbe e cila po e pengon funksionalizimin e linjës 400kV Kosovë- Shqipëri që nga viti 2016. Në kuadër të përkrahjes së Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë nga delegacioni u potencua përkrahja e plotë e projektit të instalimit të paneleve solare dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë në objektet e KOSTT.

z. McCormack, u shpreh i kënaqur me progresin në KOSTT si dhe shprehu gatishmërinë për mbështeteje të mëtutjeshme. Të pranishëm në takim ishin edhe drejtori regional për EJL dhe Kaukazin e Jugut i GIZ, z. Jakob Doetsch dhe znj Ganimete Huruglica zv.drejtoreshë e KfW në Kosovë.

## KOSTT nënshkroi Letër Bashkëpunimi me USAID dhe Tetra Tech për zbatimin e programit për barazinë gjinore dhe fuqizimin e pozitës së grave në ndërmarrje

Gjatë muajit Nëntor 2018, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, KOSTT sh.a, i udhëhequr nga kryeshefi ekzekutiv, Ilir M. Shala dhe bashkëpunëtorët e tij, e mirëpriten znj. Karen Stefiszyn dhe znj. Jasmine Boehm, përfaqësuese të Tetra Tech, të kontraktuar për programin e USAID "Engendering Utilities", për të zhvilluar diskutime të thella mbi mundësitë për avancimin e barazisë gjinore në KOSTT.



I filluar në vitin 2015, programi "Engendering Utilities" përfaqëson angazhimin e USAID-it për të promovuar një rrugë drejt qëndrueshmërisë në vendet në zhvillim duke nxitur inovacionin e ndërmarrjeve, rritjen ekonomike gjithëpërfsirëse, barazinë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave. Programi fuqizon operacionet e sektorit të energjisë duke identifikuar dhe zbatuar praktikat më të mira të barazisë gjinore, në të njëjtën kohë duke ndihmuar ndërmarrjet në përbushjen e objektivave të tyre të biznesit.

Me këtë rast, z. Shala nënshkroi një Letër Bashkëpunimi për të shfaqur përkushtimin e KOSTT-it për t'u bërë partner i projektit "Engendering Utilities". USAID-i dhe KOSTT-i do të punojnë së bashku për ta arritur barazinë gjinore brenda kompanisë me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes profesionale të grave, madje edhe në rolet udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Gjithashtu, ata do të përpilen që brenda KOSTT-it të krijojnë një fuqi punëtore më të balancuar në aspektin gjinor përmes zbatimit të ndërhyrjeve për arritjen e barazisë gjinore. Kjo do të çojë në një mjeshtësim ku barazia gjinore është vlerë thelbësore dhe gratë mund të jasin kontribut produktiv në arritjen e qëllimeve të KOSTT-it.

"Një numër gjithnjë e më i madh i dëshmive tregon se diversiteti gjinor në udhëheqje lidhet me performancë më të mirë të biznesit. Ne jemi shumë të ngazëllyer që do të bashkëpunojmë me KOSTT-in dhe që do t'i mbështesim ata drejt realizimit të një shërbimi që ofron diversitet gjinor", thanë znj. Bohm dhe znj. Stefiszyn.

## **Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a merr pjesë në Samitin e Dytë të Investimeve Ndërkombëtare dhe ekspositizen "Hidrocentralet e Ballkanit 2018"**

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z. Ilir M. Shala, mori pjesë në Samitin e Dytë të Investimeve Ndërkombëtare dhe Ekspositizen "Hidrocentralet e Ballkanit 2018", që u mbajt në tetor të vitit 2018 në Budva të Malit të Zi, e cila është një platformë e dedikuar për të sjellë së bashku ministra, investitorë të mëdhenj, vendimmarrës të hidrocentraleve kryesore dhe iniciatorë të investimeve, si dhe rregullatorë në përpjekje të bashkërenduar për të zbatuar në mënyrë efikase projektet kyçë për ndërtimin dhe modernizimin e hidrocentraleve në të gjithë rajonin e Ballkanit.



Ne ditën e dytë, në kuadër të sesionit "Projektet për ndërtimin dhe renovimin e hidrocentraleve në vendet e Ballkanit", z. Shala mbajti një prezantim me temën "Një perspektivë pse të investosh në Zonën e Kontrollit të Kosovës", ku prezantoi të arriturat dhe investimet që janë bërë në Sistemin Transmetues të Kosovës për periudhën prej themelimit të KOSTT-it dhe që kanë rezultuar me rritjen e kapaciteteve të brendshme transmetuese, kapaciteteve interkonektive, rritjen e sigurisë, besueshmërisë dhe kualitetit të furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit, integrimit e Burimeve të Ripërtëritshme (BRE) në sistemin e transmisionit, kapacitetet e BRE dhe të dhënat e energjisë dhe rëndësinë e zhvillimit të tregut të energjisë elektrike, si dhe rritjen e performancës së sistemit në përputhje me kërkesat teknike të ENTSO-E.

Si konluzion z. Shala potencoi edhe njëherë se Sistemi Transmetues i Kosovës është në gjendje të akomodojë edhe energjinë e prodhuar nga TC Kosova e Re, me kapacitet 450 MW, por edhe të gjeneratorëve tjera nga BRE. Ai paraqiti edhe problemen e balansimit të sistemit elektroenergetik, me futjen në operim të BRE. Po ashtu me theks të posaçëm, nga ky samit, i bëri thirrje institucioneve vendimmarrëse ndërkombëtare për ushtrimin e presionit ndaj palës serbe në implementimin e Marrëveshjes së Kyçës me ENTSO-E, ku KOSTT bëhet anëtar i barabartë në ENTSO-E dhe Zonë/Blllok Rregullues. Bërja Zonë/Blllok Rregulles është parakusht për lëshimin në operim të Linjës 400 kV, Kosovë – Shqipëri.

## Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT pjesë e konferencës mbi Tranzicionin e Energjisë “Sfidat dhe Mundësitë në Kosovë dhe rajon”

Nën organizim të Green Balkans Foundation dhe Germanwatch, me 31 Totor 2018 në Prishtinë u mbajt Konferenca mbi Tranzicionin e Energjisë “Sfidat dhe Mundësitë në Kosovë dhe rajon” ku u diskutua përfundimisht strategjitet e politikave si dhe rrugën drejt një tranzicioni të energjisë në Kosovë dhe në rajon. Në konferencë pjesëmarrës ishin edhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka, ambasadori i Republikës Federale Gjermane z. Christian Heldt, përfaqësues nga Zyrja e Bashkimit Evropian në krye me z. Ricardo Serri, përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë si dhe akterë të tjera të sektorit të energjisë vendorë dhe ndërkombëtar.



Pjese e panelit teknik i cili diskutoi temën “Sfidat dhe mundësitë e investimeve në sektorin e energjisë” ishte edhe Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala cili me këtë rast shprehu shqetësimin për bllokimin e implementimit të Marrëveshjes për Kyçje me ENSTO- E nga ana e Serbisë, pasi që kjo pengesë po i shkakton KOSTT-it ngecje në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike dhe përbushjen e obligimeve karshi proceseve regionale dhe obligimeve nga Traktati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Jug-lindore.

Në kuadër të diskutimeve, z. Shala foli për investimet në rritjen e kapaciteteve transmetuese të KOSTT si dhe përmirësimin e infrastrukturës transmetuese e cila është e gatshme të akomodoj kënaqshëm në rrjetin transmetues Termo-centralin Kosova e Re por edhe burimet e ripërtëritshme të energjisë elektrike. Sipas një studimi, KOSTT aktualisht akomodon 270MV kapacitet instalues për BRE-të dhe se është në konsultë me institucionet ndërkombëtare që të bëhet një studim në mënyrë që të dihet se çfarë kapaciteti është kufiri i fundit për kyçjen e BRE-ve në sistemin transmetues në mënyrë që të mos paraqiten probleme në balancim të sistemit të energjisë elektrike.

Përfundimisht në sesion të pyetjeve dhe përgjigjeve nga audiencia, z. Shala u zotua se KOSTT do të vazhdoj të jetë në përkrahje të të gjithë investitorëve që ndërlidhen me BRE-të, ”duke dhënë përgjigjet në afatet më të shkurta kohore, përkundër afateve të caktuara dhe të definuara në Metodologjinë e Taksave të Kyçjes dhe të jemi shembull për institucionet tjera që të përcjellin këto praktika si dhe të jemi atraktiv për të gjithë investitorët që të mos krijohen pengesa në realizimin e investimeve të reja”, theksoi z. Shala.

### Iniciativa e Tregut të Energjisë Elektrike (EMI)

Tregjet e energjisë elektrike në rajonin e Evropës Juglindore kryesisht janë tregje të vogla, nuk stimulojnë në mënyrë të mjaftueshme konkurrencën në prodhim dhe furnizim e cila është e nevojshme për energji të sigurt, të besueshme dhe me kosto të ulët. Tregjet e tillë nuk po arrijnë të tërheqin investimet në prodhim, transmetim dhe shpërndarje. Këto investime do të përmirësojnë qëndrueshmërinë e sistemit dhe do të ofrojnë shërbime që nxisin tregtimin ndërkufitar të energjisë.

Me qëllim evidentimin e mangësive dhe mundësive për bashkëpunim, pas një misioni fakt- mbledhës në rajon, Shoqata e Energjisë së Shteteve të Bashkuara (USEA) në bashkëpunim me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) kanë ndërmarrë një program shumëvjeçar për të nxitur integrimin dhe funksionimin e tregjeve të energjisë elektrike në Evropën Juglindore.

Ky program i ashtuquajtur Iniciativa e Tregut të Energjisë Elektrike (EMI) është një bashkëpunim i operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të tregut të Shqipërisë, Bosnie Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Serbisë dhe Sllovenisë.

Në kuadër të EMI është formuar një grup pune (EMI WG) që përbëhet nga operatorët e sistemit të transmetimit (OST), operatorët e tregut (OT), rregulatorët përkatës dhe palët e interesit rajonal si vëzhgues, që do të punojë në çështjet kryesore përmes mbështetjes teknike në fusha të tillë si: integrimi i tregut, integrimi dhe prokurimi i energjisë së ripërtërishme dhe funksionimi i sistemit. Që nga fillimi i punës së EMI, KOSTT ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e zhvilluara deri tanj, më 16 korrik 2018 ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit të EMI WG. Në takimet e rregullta që zhvillohen në kuadër të EMI WG, KOSTT përfaqësohet nga dy përfaqësues të OST dhe dy të OT.

Plani i punës në kuadër të EMI WG, përfshinë një seri të aktiviteteve afatsh-kurta (njëvjeçare) dhe afatgata (disavjeçare), dhe është i organizuar në tri fusha: 1) Përfitimet nga integrimi i tregut rajonal të energjisë elektrike; 2) Praktikat më të mira për integrimin dhe prokurimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE); dhe 3) Mbështetja teknike për nxitjen e funksionimit efektiv të tregut rajonal një ditë para, përfshirë proceset e llogaritjes dhe ndarjes (alokimit) së kapaciteteve ndërkufitare. Për secilën fushë janë paraqitur objektivat e përgjithshme, janë caktuar prioritetet dhe në përputhje me objektivat kryesore është bërë përshkrimi i detyrate të veçanta (p.sh., analizat, modelimet, trajnimet, punimet etj.) që do të përmirësojnë efikasitetin e sistemit dhe rrisin konkurrencën në tregjet e energjisë në Evropën Juglindore.



**Shykeri Morina**  
Menaxher i Sektorit për Administrim  
dhe Zhvillim të Tregut

Objektivat e EMI WG janë: aftësimi i OST-së dhe OT-së për të kryer analiza të rrjetit dhe të tregut për optimizimin e funksionimit të sistemit; identifikimi i sfidave dhe përfitimeve për bashkimin dhe integrimin e tregjeve nacionale me shumicë, tregjeve balancuese ndërkufitare dhe shërbimeve ndihmëse; mbështetja e OST-së dhe OT-së për të përmbushur detyrat e tyre në lidhje me integrimin e BRE-ve; shkëmbimi i njohurive dhe praktikave më të mira në sektorin e energjisë me ekspertë të BE-së dhe SHBA-së; si dhe ndarja e përvojave të EMI WG me OST-të dhe OT-të, politikëbërësit, rregulatorët, pjesëmarrësit e tregut të sektorit privat dhe publik dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

EMI WG ka për synim të zhvillojë kapacitete të qëndrueshme në rajon, të afta për të kryer analiza të sofistikuara teknike, të tregut dhe për të bërë rekomandime për: integrimin e tregut rajonal të energjisë elektrike; përmirësimin e funksionimit të sistemit dhe zvogëlimin e kostove të operimit; mundësinë e rritjes së konsiderueshme të burimeve të ripërtërishme të energjisë; ngritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit; inkurajimin e investimeve në infrastrukturën e re energetike dhe përmirësimin e mirëqenies sociale në Evropën Juglindore.

## Roli i KOSTT në kuadër të projektit Autostrada Digitale Ballkanike/"Balkans Digital Highway"

Në kuadër të projektit Autostrada Digitale Ballkanike/"Balkans Digital Highway", Banka Botërore (BB) ka iniciuar një seri studimesh, këshillimesh dhe punëtori informuese me vendet e rajonit për të adresuar kërkësën për shfrytëzimin e kapaciteteve të tepërtë në rrjetet ekzistuese me fije optike. Këto studime, të cilat në formë aktive u mbështetën edhe nga ana e KOSTT-it, detajuan kapacitetet ekzistuese (përfshirë edhe rrjetet interkonektive) dhe përcaktuan një plan për krijimin e një iniciative rajonale për bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës telekomunikuese.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, BB në bashkëpunim me OST, në Shtator 2018 organizoi në Tiranë një tryezë pune, për të mbledhur të gjitha OST-të nga Ballkani dhe për të diskutuar gjetjet, për të shkëmbyer përvojën në lidhje me bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës në vend, rajon dhe më gjërë dhe për të diskutuar bashkëpunimin potencial ndërvendor në këtë fushë. Kjo iniciativë, gjithnjë e më tepër po tërheqë vendet e Ballkanit Perëndimor – si Kosova, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe ndoshta Bosna e Hercegovina dhe Serbia.

Disa OST të rajonit, veçanërisht KOSTT dhe CGES (Mali i Zi), tashmë kanë filluar me aktivitete për bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës telekomunikuese brenda territorit të vendeve të veta. Por, përfitimet e mundshme mund të janë më të mëdha përmes një tregu të përbashkët rajonal, andaj të gjitha vendet pjesëmarrëse nga Ballkan Perëndimor janë angazhuar për një iniciativë të përbashkët, si pjesë e një plani rajonal të zhvillimit ekonomik.

Kështu, OST-të e Ballkanit Perëndimor formuan një grup punues për të diskutuar çështjet rajonale, ndërsa vendet individuale janë duke ndërmarrë hapa konkret për të çuar idenë përpara. KOSTT për shembull, tashmë jep në shfrytëzim rreth 36 % të segmenteve të rrjetit të vet me fibra optike Operatorëve lokal të telekomit. Maqedonia e Veriut, ndryshoi Ligjin për Energji, duke i mundësuar MEPSO-s të nisë bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës, ndërsa OST e Shqipërisë është duke përgatitur një plan për të operacionalizuar këto iniciativa.

Gjatë vitit 2019 pritet që BB të dorëzoj në KOSTT studimin e fizibilitetit për Autostradën Digitale Ballkanike/"Balkans Digital Highway" si dhe një dokumentin: "Summary of Balkans Digital Highway".

Në ndërkohë, me ndihmën e BB u ndërmor edhe iniciativa për aplikim në WBIF ("Western Balkans Investment Framework") për një grant për Asistencë Teknikë për realizimin e projektit "Balkans Digital Highway", i cili ka karakter lokal dhe rajonal sepse në te po marrin pjesë katër vende nga Ballkani Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi.

Në Shtator 2019, BB në bashkëpunim me Transelectrica nga Rumania, do të organizoj tryezën e dytë të punës në Bukuresht, për të mbledhur të gjitha OST-të nga Ballkani dhe për të diskutuar arritjet në bashkëpunimin ndërvendor në fushën e realizimit të Autostradës Digitale Ballkanike.

Këto zhvillime, të cilat po mbështeten në mënyrë aktive nga ana e KOSTT-it, pritet të çojnë në përdorimin më optimal të infrastrukturës, të promovojnë zgjerimin e qasjes me shpejtësi të lartë brez-gjerë dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimit brez-gjerë ("broadband"), veçanërisht në zonat rurale.

## **KOSTT shpërblehet me çmimin Mbështetësi më i gjatë i njëpasnjëshëm nga Fondi Kosovaro-Amerikan për Edukim**

Në mbrëmjen e 7 Dhjetorit 2018, nën organizim të Fondit Kosovaro-Amerikan për Edukim (KAEF) u mbajt ngjarja "The night of the rising stars 2018", ku u promovua ndarja e bursës së 100-të për të rinjët Kosovarë, mbrëmje kjo në të cilën Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a u shpërblye me mirënjojen Mbështetësi më i gjatë i njëpasnjëshëm/The Longest Consecutive Donor. Mbrëmja mblodhi përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe udhëheqës të biznesit dhe komunitetit.

Në fjalën e tij të rastit me pranimin e këtij çmimi të rëndësishëm, zv. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Kadri Kadriu theksoi "Si partner aktiv që nga viti 2010 i KAEF, KOSTT edhe më tutje do të vazhdoj të jetë donator dhe promovues i vlerave të vetëdijesimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe një të ardhme të ndritshme të vendit përmes edukimit të rinisë së Kosovës".

Shënim: Fondi Kosovar Amerikan i Arsimit (KAEF) është i dedikuar në zhvillim afatgjatë ekonomik të Kosovës përmes edukimit të popullit të saj. KAEF siguron deri në 8 bursat pasuniversitare në vit për të rinjët duke premtuar shkollim dhe trajnime të nivelit të lartë në universitetet e përzgjedhura të SHBA.



*Nagip Syla,  
Menaxher i sektorit për Telekomunikime*



## U mbajt Tryezë Pune më temë “APEX Tregu i Përbashkët Energjetik një ditë para dhe brenda ditës ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë”

Nën organizim të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOSTT sh.a, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe IFC World Bank Group, me 26 Nëntor 2018 në Prishtinë u mbajt Tryezë Pune me temën “APEX Tregu i Përbashkët Energjetik një ditë para(D-1) dhe brenda ditës (D) ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë”.



Në këtë rast në fjalën e tij hyrëse Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala, theksoi rëndësinë e kësaj Tryze duke pasur parasysh aspektet teknike dhe legale që janë të nevojshme të zhvillohen për themelimin e tregut të përbashkët si dhe punën konkrete nga ekspertët e angazhuar nga KOSTT dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, konsulencia e angazhuar nga USAID përmes Repower dhe nga IFC. “Projekti i bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike është projekt qe ka për qëllim bashkimin e tregjeve komplementare të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë. Mirëpo që këto dy tregje të janë funksionale në kuadër të një tregu për qellim të tregtimit një ditë para dhe gjatë ditës është domosdoshmëri e rendit të parë që në aspektin operativ KOSTT të bëhet zonë/bllok rregulluese. Pra që tregu i përbashkët të funksionalizohet është e domosdoshme që linja 400kV Kosovë-Shqipëri të jetë në operim, prandaj në kuadër të kësaj Tryze duha të përçoj mesazhin tek të gjitha institucionet financiare që e përkrahin këtë projekt qe të bëjnë presion tek pala serbe që të mos pengoj hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT-ENTSO-E e cila mundëson që të jetësuhet edhe projekti i tregut të përbashkët!, theksoi z. Shala Gjithashtu z. Shala uroi grupet punuese të kësaj punëtorie në realizimin sa më të shpejt të këtij projekti.

Në kuadër të Tryezës, tri panele të ndara me ekspert të fushës nga kompanitë prestigjoze ndërkombëtarë si Nord-Pool, IFC, KOSTT dhe Statkraft, dhanë sqarime për audiencën mbi parimet e funksionimit të tregut dhe procesin e themelimit dhe operimit të bursës shqiptare të energjisë (APEX) ku Kosova përmes KOSTT do të jetë aksionale. Në panelin e parë u prezantua Modeli i Tregut dhe Modeli i Qeverisjes të bursës së energjisë shqiptare APEX duke përfshirë efektin e zonave tregtare Kosove- Shqipëri, bashkimin e tregut, tregtimin bilateral, tregtimin në zonën e importit/eksportit, rregullat e operimit të tregut në APEX, barazimin përfundimtarë dhe tregun balancues. Në panelin e dytë nga ekspertet e Nordpool është bërë një demonstrim në platformë për tregtim në Bursën e energjisë në Nordpool.

Në panelin e tretë në kuadër të kësaj Tryze u bë prezantimi nga KOSTT përmes, zv.Kryeshefit z.Kadri Kadriu. Z. Kadriu para palëve relevante të interesit diskutoi rreth progresit në themelimin e bursës shqiptare të energjisë (APEX), mundësitë aktuale të tregtimit në tregun e Kosovës në të ardhmen si dhe prezantoi Udhërrëfyesin e bashkimit të tregjeve dhe bashkërendimin e aktiviteteve për përfshirjen e Kosovës në kuadër të bursës shqiptare të energjisë. Një eksperiencë të rëndësishme për palët tregtare në Kosovë ka dhënë përfaqësuesi i kompanisë tregtare Statkraft.

Të pranishëm në këtë Tryezë pune ishin palët kryesore të sektorit të energjisë në Kosovë si KOSTT, KEK, KEDS, KESCO, ZRRE, palët tregtare në Kosovë dhe Shqipëri si dhe përfaqësuesit e institucioneve të sektorit të energjisë të Shqipërisë.

